



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Udhëzim

(Sistemi trevjeçar dhe ai i mentorimit)

Lidhur me dy prezantimet e progresit të arritur kërkimor në disertacionin e doktoratës së kandidatëve të regjistruar në sistemin trevjeçar të studimeve.

Në bazë të nenit 22, të **Rregullores për Ciklin e tretë të studimeve**, kandidati i doktoratës dhe mentori duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm për ta diskutuar progresin e disertacionit.

- Gjatë punimit të disertacionit të doktoratës, kandidatët e kanë për detyrim të bëjnë dy prezantime publike para komunitetit akademik.
- Kandidati dhe mentori mund t'i shqyrtojnë komentet dhe këshillat e dhëna, gjatë prezantimeve, për përmirësimin e disertacionit dhe duhet t'i përfshijnë këto në raportin gjashtëmujor.
- Preferohet që kandidati në prezantimin e parë të ketë të shkruara më së paku 50 faqe te disertacionit, kurse në prezantimin e dytë mbi 100 faqe. Ky është material i shkruar, i cili duhet të prezantohet e jo pjesë të shkëputura të tij. Nuk preferohet prezantim i propozim-tezës, e cila është prezantuar në Këshillin mësimor shkencor (KMSH).

Me qëllim që të sigurohet një përkrahje më e madhe, por edhe që të lehtësohen aspektet praktike të dy prezantimeve:

- Kandidatët duhet të bëjnë prezantimin e tyre në grup, dy e më tepër kandidatë nga i njëjti fakultet. Kjo, bëhet me qëllim që të ketë transparencë më të madhe dhe të jepet ndihmë reciproke me sugjerime për perfeksionimin e kërkimit shkencor dhe shkrimit të disertacionit.
- Për sistemin mentorial, mentori pas prezantimit shkruan dhe fut në dosje një raport të shkurtër për progresin dhe kopjen e shpallur të prezantimit për publikun.

Shënim: Fakultetet vetë gjejnë forma që ta verifikojnë numrin e faqeve të shkruara para se ta shpallin publikimin.